

MBRËMJA KUR'ANORE

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾ . صدق الله العظيم

“Libër i begatshëm, Ne t’a shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend” (Sad,29)

Të gjitha falenderimet i përkasin të Plotëfuqishmir, All-llahut xh. Sh. Krijuesit dhe Edukuesit të krijesave të gjithësisë, atij që nuk ka shok, që na ka lindur prej kujt e që askush nuk ka lindur prej tij, i Dituri absolut e i pa të metë.

Salavatet e lëvdatat ia drejtojmë hazreti Muhammedit a.s. pejgamberit që na ka sjellur mesazhin e All-llahut xh. Sh., Kur’ani kerimin; fjalët më të përzgjedhura i meriton familja e tij e pastër, shokët e tij të nderuar dhe të gjithë ata që ndoqën dhe do ta ndjekin rrugën e Islamit.

Të dashur besimtar dhe besimtare,

Kur’ani është Fjalë e All-llahut xh. Sh., Libër i cili iu shpall Muhammedit a.s.. Kur’ani është mrekulli e cila përmbanë sistemin e jetës së njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër. Me leximin e fjalëve të Kur’anit besimtari bën ibadet, duke falur namazin, duke kryer ibadetet tjera islame, por edhe me vetë leximin e Kur’anit muslimani bën ibadet.

Këto dhe shumë arsye tjera muslimanët e botës, prej të parëve të cilët jetuan në kohën e Muhammedit a.s. dhe deri te ne sot, ruajtjes së Kur’ani kerimit i kushtuan vëmendjen e veçant dhe krahas garancës së All-llahut xh sh. Për mbrojtjen e tij nga ndryshimet e mundshme, muslimanët Kur’anin e ruajtën në origjinal, ashtu si iu Shpall Muhammedit a.s. dhe do ta ruajnë deri në fundin e jetës së kësaj bote. Do ta ruajnë sepse ai është i vetmi burim i shëndosh për organizimin e jetës së njeriut në kuptim individual, në kuptim familjar dhe në kuptim shoqëror, është burim i vetëm pa alternativë sepse e shpalli Ai i cili dinë se çka është njeriu, din se kush është njeriu, din se çka i nevojitet njeriut, pra Ai e krijoi njeriun. Të gjithë ata që nuk respektojnë mësimet Kur’anore, sherrin ia panë vetes, por ama e keqeja është se sherrin e tyre ua panë edhe të tjerët. Mbi të gjitha të keqen e shmangies mësimëve kur’anore ia panë vetë muslimanët, përkundër porosisë së Muhammedit a.s. se aty është e keqeja më e madhe e jetës së njeriut dhe e tërë gjinisë së tij.

Besimtarë të dashur,

Si mund të largohesh nga mësimet kur’anore kur e dijmë të gjithë se të vetmin shpëtim që ia garanton njeriu jetës së tij është mësimi hyjnor – pra mësimet kur’anore. Shih për këtë, s’ka dyshim se Kur’ani afirmoi lidhjen e drejt përdrejt të njeriut me Zotin duke mohuar çdo formë të lidhjeve tjera. Me kultivimin dhe afirmimin e jetës individuale të njeriut, kuptohet se kultivon jetën shoqërore

nëpërgjithësi fati i së cilës është mu në mësimet kur'anore. Pra, Islami është bashkësia e njerëzve të barabartë, të vëllezëruar shpirti i së cilës është përplotë me të Vërtetën, zemra e së cilës është e mbushur me Mirësinë dhe akti i fundit i saj është i mbështetur në Drejtësinë.

Vëllezër dhe motra,

Kur'ani kerimi, krahas kësaj që thash, është mrekulli hyjnore. Mrekullia e Kur'ani kerimit shihet në shumë fusha, pra është shumë dimensionale:

- Kur'ani kerimi në vete ngërthen mrekullinë shkencore që nuk e ka pasur asnjë libër i shpallur më parë. Për këtë vetë ju jeni dëshmitar se shkencëtar të lëmive të ndryshme mbështetjen e vete e gjejnë mu në ajetet kur'anore,
- Kur'ani kerimi në vete ngërthen mrekullinë gjuhësore dhe për këtë mjafton të përkujtojmë se në saje të kësaj mrekullia gjuha arabe prej se kur ekziston e gjer më sot nuk ka përjetuar kurrfarë ndryshimesh,
- Kur'ani kerimi në veti është mrekulli për ta mësuar për mendsh. Këtë më së miri e shohim te muslimanët e botës pavarësisht përkatësinë e tyre etnike. Ndodh që muslimani të mos e din gjuhën arabe, por shumë bukur e lexon Kur'anin dhe shumë lehtë e mëson përmendsh, dhe
- Kulmin e mrekullisë kur'anore ne do ta përjetojmë sot bashkërisht përmes leximit/këndimit të Kur'ani kerimit. Melodia, format e këndimit, zëri i cili del gjatë leximit të ajeteve kur'anore në vete janë mrekulli. Dhe ne sot jemi të nderuar me leximin e ajeteve kur'anore të cilët do t'i dëgjojmë nga kënduesit e nderuar që na vijnë nga vende të ndryshme të botës islame.

Andaj më lejoni që në emrin tim dhe në emër të BFI-së në RM t'ju dëshiroj çaste të këndshme, dëgjim vigjilent të ajeteve kur'anore me dëshirë që ky lloj aktiviteti i kultvimit të jetës fetare në mjediset tona të jetë tradicional.

Ves-selamu alejkum.

ZV/REISUL ULEMA I BFI-së
Prof. Bahri ALIU

(Aktivitet i përgaditur në bashkëpunim: BFI e RM dhe Shoqata DENIS FENER nga Gjermania. Të ftuar kurra të Kur'ani kerimit nga bota islame. Aktiviteti u mbajtë në sallën Univerzale - Shkup